



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kadastrit
Periudha raportuese	Prill, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Valbona Osmani – Mehmetaj, drejtore e Drejtorisë së Kadastrit

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes / ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhuruara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit **prill 2020**, në zyrat pritëse janë pranuar gjithsej **9360** kërkesa, nga të cilat janë aprovuar **9337** kërkesa, refuzuar **1** kërkesa dhe kanë mbetur në procedurë edhe **22** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes **2 sektorëve**: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Kadastrit janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastralë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njërive banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

- Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

Në Drejtorinë e Kadastrit në Prishtinë gjatë muajit **prill 2020**, nëpërmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve, atij të kadastrit dhe gjeodezisë, janë pranuar kërkesa të ndryshme, prej të cilave:

Në Sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:

- **69** kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë aprovuar **57**, është refuzuar **1** kërkesë për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me **11** konkluzione, duke u pezulluar procedura deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse;
- **2** kërkesa për historik, nga persona fizikë dhe institucione, prej të cilave është aprovuar **1**, ndërsa kanë mbetur në procedurë edhe **1**;
- **14** shkresa, kërkesa nga institucionet e ndryshme, ku janë aprovuar **të gjitha**;
- Kërkesa për përmirësim me pagesë nuk ka pasur;
- Nuk ka pasur kërkesa për lirim të barrës tatimore dhe kërkesa për vendosjen e barrës tatimore;
- **21** kërkesa për regjistrim të hipotekave dhe **11** kërkesa për çregjistrim hipoteke, ku janë aprovuar të gjitha;
- **28** përmirësime/ankesa/plotësim lënde nga institucionet e ndryshme, ku janë aprovuar të gjitha.

Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar për këtë sektor ka qenë 145, nga të cilat 132 kërkesa janë aprovuar, 1 është refuzuar dhe 12 kërkesa kanë ngelur në procedurë.

Në Sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:

- **9050** kërkesa për certifikata të pronësisë dhe kërkesa për kopje të planit, ku janë aprovuar të gjitha;
- **15** kërkesa për ndarje të parcelave, ku janë aprovuar të gjitha;
- **13** kërkesa për bashkim të parcelave, ku janë aprovuar të gjitha;
- **9** kërkesa për përcaktim të kufijve, ku janë aprovuar të gjitha;
- **12** kërkesa për rirregullim kufiri të parcelave dhe janë aprovuar të gjitha;
- **10** kërkesa për identifikimin të parcelave-njësive banesore, prej të cilave janë aprovuar **10**;
- **54** kërkesa për dhënien e produkteteve (koordinatave) dhe janë aprovuar të gjitha;
- **8** kërkesa për ndërrimin e destinimit të tokave – parcelave dhe janë aprovuar të gjitha;
- **11** kërkesa për legalizimin e objekteve dhe janë aprovuar të gjitha;
- **12** plotësime të lëndëve dhe janë aprovuar të gjitha;
- **6** kërkesë për regjistrim të objekteve dhe njësive banesore dhe janë aprovuar të gjitha;
- **13** kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet, si: Drejtoria e Pronës, Drejtoria e Urbanizimit, Ministria e Planifikimit Hapësinor, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj., dhe janë aprovuar të gjitha.

Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar për këtë sektor ka qenë: 9215, prej të cilave janë aprovuar 9205 dhe 10 kanë mbetur në procedurë.

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se Drejtoria e Kadastrit ka implementuar gati **97** për qind (%) të planit të saj, duke i aprovuar, refuzuar dhe pezulluar kërkesat e palëve në procedurë, sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa.

E arritur e kësaj Drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve, ka arritur të nxjerrë vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët /subjektet juridike.

4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.*

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej **5** ditë punë, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA, verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

Aktivitetet që janë në implementim e sipër nga Sektori i gjeodezisë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;
- Lëndët për identifikimin e njësive banesore;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

4.1.1. *STATISTIKAT*

-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të këtë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit, prill 2020	Numri total i kërkesave	Të aprovuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara €
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i së drejtës për pronë të paluajtshme)	69	57	1	11	2.732.00
Kërkesa për historik zyrtar, historik për persona fizikë dhe juridikë	2	1	0	1	120.00
Kërkesa nga Institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe	14	14	0	0	00.00

Institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së					
Përmirësime në RDPP	0	0	0	0	0.00
Vendosje të barrës tatimore	0	0	0	0	00.00
Lirim nga barra tatimore	0	0	0	0	00.00
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	21	21	0	0	3,910.00
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	11	11	0	0	130.00
Kërkesa të tjera: përmirësime, ankesa, plotësime lënde etj.	28	28	0	0	260.00
Certifikata të pronësisë & kopje të planit	9050	9050	0	0	10,085.00
Ndarje – parcelimet, copëtimet	15	15	0	0	950.00
Bashkimi i parcelave	13	13	0	0	842.00
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	54	54	0	0	740.00
Legalizimi i objekteve	11	11	0	0	00.00
Identifikimi i parcelave dhe njësive banesore	10	0	0	10	350.00
Përcaktimi i kufijve të parcelave	9	9	0	0	193.00
Rirregullimi i kufijve të parcelave	12	12	0	0	480.00
Ndërrimi i destinimit të tokës-parcelave	8	8	0	0	195,00.00
Plotësimi i lëndëve	12	12	0	0	00
Regjistrimi i objekteve dhe njësive banesore	6	6	0	0	5,480.00
Kërkesa zyrtare nga institucionet-Shërbimi i gjeodezisë (certifikata dhe kopje plani)	15	15	0	0	520.00
Gjithsej	9360	9337	1	22	24,060.00

4.1.2 *Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.*

Drejtoria e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastralë, përkundrazi, kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

4.1.3 *Takimet me palë*

- **Sektori i kadastrit** - gjegjësisht Zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP) për shkak të pandemisë COVID -19, ka ndërprerë të gjitha takimet e rregullta me palë, të cilat janë mbajtur dy herë në javë (*të martave dhe të enjteve*) nga 2 orë në ditë, me dy zyrtarë ligjorë, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palës.
- **Sektori i gjeodezisë** - ka takime të rregullta me palë një herë në javë (të mërkurave) nga 2 orë, ku gjatë muajit **mars** ka pranuar /// palë për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu, ka takime me palë për identifikimin e banesave, si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

5. *Takimet me institucione të tjera*

- **Sektori i kadastrit** nuk ka pasur takime për shkak pandemisë Covid-19.

5.1.1 *Diskutime publike/takimet me qytetarë* nuk kemi pasur.

6. *Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare.*

6.1.1 *Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.*

- **Sektori i kadastrit:**

- Lëndë të pranuar: **145;**
- Lëndë të aprovuara: **132;**
- Lëndë të refuzuara: **1;**
- Lëndë në procedurë: **12.**

- **Sektori i gjeodezisë:**

- Lëndë të pranuar: **9215;**
- Lëndë të aprovuara: **9205;**
- Lëndë të refuzuara: **0;**
- Lëndë në procedurë: **10.**

Takime të tjera nuk kemi pasur.

7. **SFIDAT**

- Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

Sfidë e jashtëzakonshme për Sektorin e Kadastrit gjatë kësaj periudhe ka qenë numri i zvogëluar i stafit, të cilët janë liruar sipas Urdhërësës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shkak të pandemisë COVID -19, dhe gjithashtu kemi lajmëruar një rast në Policinë e Republikës së Kosovës për falsifikimin e dokumentit zyrtar, vepër kjo e dënueshme sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Spektori i kadastrit:

- Sfidues është komunikimi me institucionet, moskthimi i përgjigjeve në afate ligjore, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve;
- 0 kërkesa presin për verifikime në Arkiv Komunal dhe Ndërkomunal (lëndë nga muaj paraprak);
- 22 kërkesa presin për verifikime në Gjykatë (lëndë nga muaj paraprak);
- 2 kërkesa presin për verifikime në Privatizim (lëndë nga muaj paraprak);
- 2 kërkesa presin për verifikime në NPB (lëndë nga muaj paraprak);
- 23 kërkesa presin për verifikime në AKKVP (lëndë nga muaji paraprak).

Spektori i gjeodezisë:

- Sfidues është komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, mosdhënia e përgjigjeve në lidhje me problemet që hasim çdo ditë me programin **Cadastral Map** dhe **SIKTK**, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve;
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruktimit të disa zonave kadastrale nga **Agjencia Kadastrale e Kosovës**.

8. **REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shitesë etj.**

Spektori i kadastrit:

- Trajnime për punëtorë, sa i përket administratës dhe funksionimit të saj.

Spektori i gjeodezisë:

- Trajnime për punëtorë.

9. **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES**

-Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike, në afat prej 5 ditë pune;
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët për verifikim në gjykata, NPB, AKP, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

Sektori i gjeodezisë:

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie të produktëve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësive banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët, apo kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

10. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen, e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.